



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

I

AVOKATIT TË POPULLIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

A.186/2017

Arben Hajrullahu

kundër

Rektoratit të Universitetit të Prishtinës dhe Fakultetit Filozofik

Përkitazi me pretendimet e ankuesit për trajtim të pa barabartë të kandidatëve, në konkursin publik të datës 24 nëntor 2016, të shpallur nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, për zgjedhjen e personelit akademik për mësimdhënës, në Fakultetin Filozofik.

Drejtuar:

- *Z. Shyqiri Bytyqi, Ministër, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë*
- *Z. Marjan Dema, Rektor, Rektorati i Universitetit “Hasan Prishtina”*
- *Z. Bujar Dugolli, Dekan, Fakulteti Filozofik, Universiteti i Prishtinës*

Prishtinë, më 2 nëntor 2018

Qëllimi i Raportit

1. Raporti ka për qëllim të tërheqë vëmendjen e Rektoratit të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", (më tej: UP) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (më tej: MASHT), përkatësisht Inspektoratit të Arsimit në këtë ministri, lidhur me shkeljet dhe veprimet diskriminuese të pretenduara nga ankuesi në konkursin publik të shpallur nga UP, më datës 24 nëntor 2016, për zgjedhjen e personelit akademik.
2. Ky raport është i bazuar në ankesën individuale të z. Arben Hajrullahu (më tej *ankuesi*) të drejtuar në Institucionin e Avokatit të Popullit, dhe mbështetet në faktet dhe provat e ankuesit, si dhe nga shkresat e lëndës të cilat i posedon Institucionit i Avokatit të Popullit (IAP). Në bazë të nenit 15, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 16 mars 2017, ka pranuar ankesën e z. Arben Hajrullahu kundër Fakultetit Filozofik dhe Rektoratit të UP në Prishtinë lidhur me çështje të punësimit.

Rrethanat e rastit

3. Institucioni i Avokatit të Popullit, në bazë të nenit 15, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 16 mars 2017, ka pranuar ankesën e z. Arben Hajrullahu kundër Fakultetit Filozofik dhe Rektoratit të UP lidhur me çështje të punësimit.
4. Sipas pohimeve të ankuesit, më 24 nëntor 2016, UP ka shpallur konkurs publik për zgjedhjen e personelit akademik. Në këtë konkurs kishte aplikuar edhe ankuesi për rizgjedhje, përkatësisht për avancim në pozitën në të cilën ishte zgjedhur nga Senati i UP, së pari si Profesor Asistent, në vitin 2006, dhe më pas, si Profesor i asocuar, në vitin 2011.
5. Sipas pohimeve të ankuesit, pas kërkim sqarimit verbal nga Dekani i Fakultetit Filozofik dhe anëtarët e Komisionit Vlerësues, më 27 janar 2017, ankuesi kishte deponuar sqarim me shkrim, për çështjet e ngritura, që janë konsideruar të paqarta, në dosjen e aplikimit të tij. Këto sqarime kishin të bëjnë me sistemin e studimeve në Austri, si çështjen e barazvlerës dhe nostrifikimit të studimeve të magjistraturës. Ankuesi pohon se, në këtë shkresë, mes tjerash, kishte theksuar se në vitin 1994, ai kishte përfunduar shkollimin e mesëm dhe në vitin akademik 1994/1995, kishte qenë student në UP, ndërsa në 1995/1996, kishte studiuar në Universitetin e Grazit në Austri, për absolvimin e provimit universitar të gjuhës gjermane. Gjatë periudhës kohore 1 tetor 1996 deri më 1 mars 1999, ankuesi pohon se i kishte vazhduar studimet, si student i rregullt i Universitetit të Grazit. Gjatë kësaj periudhe kohore, ankuesi pohon se Sistemi i Bolonjës, ashtu siç njihet sot me studimet e Bachelor (3 vjet) dhe Master (2 vjet), nuk ka qenë i aplikueshëm në sistemin e arsimit të lartë të Austrisë. Sipas tij, studimet bazike/themelore kanë nënkuptuar grumbullimin e një numri të kredive dhe për çdo kurs të përfunduar studenti ka marrë dëftesë/çertifikatën e provimit. Këto dëftesa/çertifikata të provimit kanë rezultuar edhe me gjithsej katër "*Diplomprüfungszeugnis*", të cilat, sipas ankuesit, mund të konsiderohen si ekuivalente me diplomën e studimeve bazike/themelore. Më pas, ankuesi pohon se gjatë viteve 1999-2002, kishte vazhduar studimet në Universitetin e Vjenës, prej ku e mori titullin Magjistër i Filozofisë (Mag.Phil.), drejtimi Shkenca Politike. Ndërkohë, edhe Vendimi i këtij universiteti, për ndarjen e këtij titulli, është nostrifikuar nga MASHT në Kosovë, më 24 janar 2017.

6. Gjithashtu, sipas pohimeve të ankuesit, në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit Filozofik, më 9 shkurt 2017, është diskutuar edhe çështja e aplikimit të ankuesit. Kryetari i Komisionit Vlerësues dhe një anëtar i këtij komisioni kanë nënshkruar, “*Raportin e Komisionit Vlerësues për Zgjedhjen e Personelit Akademik*”, duke propozuar zgjedhjen e tij në thirrjen e Profesorit të rregullt, ndërsa, anëtari i caktuar nga Dekani i Fakultetit Filozofik, ka përfaqësuar mendim të ndarë. Ankuesi pohon se, bazuar në procesverbalin e kësaj mbledhje, Dekani i këtij Fakulteti, z. Bujar Dugolli kishte pohuar se në dosjen e aplikimit të ankuesit në këtë konkurs mungon diploma e studimeve themelore (BA) dhe njohja –barazvlera e diplomës Master (MA) nga MASHT. Më pas, Këshilli i Fakultetit Filozofik votoi pro përsëritjes së konkursit, pasi që asnjëri nga kandidatët nuk e ka dosjen e aplikimit të kompletuar, siç kërkohet me konkurs. Rekomandimi i këtij Këshilli ishte që pozita në fjalë të rishpallet. Ky propozim u miratua me vetëm një votë kundër dhe tre abstenime.
7. Sipas ankuesit, në procesverbalin e sipërpërmendur, pozitat e tjera në konkurs si mësimdhënës, përfshirë edhe pozitën numër 5 dhe pozitën numër 6, për kandidatët Z.H. dhe H.I., propozohen nga Këshilli për Profesor të rregullt, respektivisht për Profesor të asocuar.
8. Përkitazi me këtë çështje, ankuesi pohon se i është bërë diskriminim nga Këshilli në fjalë, sepse, në rastin e tij, u kërkua rishpallja e konkursit, kurse në konkursin e njëjtë për dy kandidatët tjerë (Z.H dhe H.I.) nuk rekomandohet rishpallja e konkursit, edhe pse, që të dy, me rastin e aplikimit, sipas ankuesit, nuk kishin thirrje MA të nostrifikuara nga MASHT.
9. Më 20 shkurt 2017, ankuesi i është drejtuar me kërkesë për parandalimin e keqpërdorimeve në konkursin publik, si dhe parandalimin e aplikimit të normave në fuqi në mënyrë selektive dhe diskriminuese, përkatësisht shkeljes së të drejtës në punë dhe të drejtave të njeriut, Rektoratit të UP-së, MASHT-it, Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport të Kuvendit të Kosovës, Avokatit të Popullit, Agjencisë Kundër Korrupsionit, Agjencisë së Kosovës për Akreditim, Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës, Ambasadës Britanike në Prishtinë, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë dhe Ambasadës Austriake në Kosovë.
10. Më 31 mars dhe më 13 prill 2017, ankuesi pohon se nëpërmjet postës elektronike kishte parashtruar kërkesë tek Sekretarja e Fakultetit Filozofik, për marrjen e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Fakultetit Filozofik, të mbajtur më 9 shkurt 2017, por ankuesi pohon se nuk kishte pranuar ndonjë përgjigje.
11. Më 13 prill 2017, ankuesi parashtroi ankesën me nr.prot.213, në Inspektoratin e Arsimit në MASHT me pretendime se Këshilli i Fakultetit Filozofik ka kryer veprime diskriminuese ndaj tij, prandaj, ka kërkuar që Inspektorati i Arsimit të ndërmarrë veprime të menjëhershme, bazuar në kompetencat ligjore.
12. Më 12 maj 2017, Inspektorati i Arsimit u përgjigj në shkresën e ankuesit, duke pohuar se kishin bërë një inspektim special në Rektoratin e UP-së, si dhe në Fakultetin Filozofik, por sipas tyre, në atë kohë, çështja për të cilën ankuesi kishte parashtruar ankesë, ishte në procedurë, prandaj Inspektorati i Arsimit pezulloi shqyrtimin e ankesës së

protokoluar të ankuesit të datës 13 prill 2017, me nr.prot.213, deri në përfundim të lëndës nga organet kompetente. Për më tepër, Inspektorati i Arsimit thekson se rishqyrtimi i lëndës do të bëhet pasi të merret vendim nga organet kompetente, si dhe pasi të jenë shterrur të gjitha mjetet juridike, sipas hierarkisë.

13. Ankuesi pohon se Senati i UP ka nxjerrë edhe Vendimin nr.prot.2/22, të datës 7 korrik 2017, sipas të cilit ai rizgjedhet në thirrjen akademike Profesor i asociuar dhe se pozita në të cilën ankuesi ka aplikuar si Profesor i rregullt do të rishpallet në bazë të propozimit të Këshillit të Fakultetit Filozofik në Senatin e UP, megjithatë, nuk ka pranuar ende përgjigje nga Inspektorati i Arsimit.
14. Lidhur me rastin, IAP, më 24 tetor dhe 27 dhjetor 2017, i dërgoi letra të ndara Rektorit të UP-së, për të kërkuar informata lidhur me pretendimet e ankuesit.
15. Më 11 janar 2018, IAP pranoi përgjigje nga Rektori i UP-së, z.Demaj, ku mes tjerash, theksohet se propozimet paraprake të Komisionit Vlerësues dhe të Këshillit të Fakultetit, nuk janë vendime. Çdo ankesë drejtuar Senatit apo menaxhmentit të UP-së, para se të merret vendim përfundimtar nga Senati, konsiderohet e parakohshme dhe rrjedhimisht e pabazuar dhe nuk përbën obligim për shqyrtim nga organet përkatëse të UP-së, duke pasur parasysh se procedurat e ankimimit janë në mënyrë taksative të precizuara në konkursin publik.
16. Në këtë përgjigje të Rektorit është bashkangjitur edhe Vendimi me nr. 2/22 i datës 7 korrik 2017, i Senatit, për rizgjedhjen e ankuesit në thirrjen e njëjtë që e kishte edhe më parë, si Profesor i asociuar. Në këtë vendim, mes tjerash, theksohet se Këshilli i Fakultetit Filozofik i ka propozuar Senatit të UP-së që pozita në të cilën ka aplikuar ankuesi (si Profesor i rregullt), të rishpallet dhe, sipas këtij Vendimi, ankuesi rizgjedhet si Profesor i asociuar.

Baza ligjore

17. Kushtetuta e Republikës së Kosovës në Nenin 21, paragrafi 2 dhe 3 përcakton se:
“Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. Çdokush e ka për detyrë t’i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve.”
18. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 24, përcakton se *“Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim, askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhje kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal”.*
19. Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafin 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, *“ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
20. Neni 53 i Kushtetutës përcakton: *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës*

Evropiane për të Drejtat e Njeriut”, ndërsa neni 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përcakton se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

21. Ligji për mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 2, e përcakton fushëveprimin sipas së cilit “ *Ky ligj zbatohet për të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit, kriteret e përzgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, përfshirë avancimet, qasje në të gjitha llojet dhe nivelet e udhëheqjes profesionale, trajnimeve profesionale, trajnimit të avancuar profesional dhe rikualifikimet përfshirë edhe përvojën e punës praktike [...] çfarëdo të drejthe tjetër të paraparë me legjislationin në fuqi.*
22. Neni 3 përcakton konceptin e diskriminimit ku “*Parimi i trajtimit të barabartë nënkupton se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilësdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji*, ndërsa Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cenoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Ndërsa procedurat në organet kompetente, **sipas nenit 12**, përcaktojnë se **Çdo person apo grup i personave mund t’i parashtrijë ankesë Avokatit të Popullit lidhur me sjelljen diskriminuese mbi bazat e përmendura në nenin një (1) të këtij Ligji.**”
23. Neni 20 i Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi përcakton qartë se “*Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin prova para organit administrativ apo gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë dhe se barra e provave bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë*”.
24. Neni 1 i Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente publike: “*garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike*”.
25. Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në nenin 16, paragrafi 4, përcakton se IAP ka kompetencë të bëjë hetime, qoftë për t’iu përgjigjur **ankesës së parashtruar** apo me iniciativën e vet (Ex Officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

26. Gjithashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në nenin 18, par. 1 përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka edhe këto përgjegjësi:

- “të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre” (pika 1),
- “të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla” (pika 2);
- “të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave” (pika 4);
- “të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (pika 5);
- “t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (pika 6);
- “të përgatitë raporte vjetore, periodike dhe të tjera mbi gjendjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit dhe të kryej hulumtime mbi çështjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, barazisë dhe diskriminimit në Republikën e Kosovës” (pika 8);

Analiza ligjore

27. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se Kushtetuta, si akti më i lartë juridik i një vendi, mbrohet dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj është në interes të funksionimit të shtetit të së drejtës zbatimi dhe realizimi praktik i këtyre të drejtave. Garancitë kushtetuese i shërbejnë mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe funksionimit të shtetit ligjor. Kushtetuta në nenin 21, shprehimisht përcakton obligimin e të gjitha organeve për t’i respektuar liritë dhe të drejtat e njeriut, prandaj ky parim është imperativ dhe duhet të respektohet nga të gjithë, përfshirë këtu në rastin konkret edhe Rektoratin e UP-së.

28. Në kuptim të dispozitës së nenit 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Avokati i Popullit rikujton se Konventa përcakton se gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

29. Avokati i Popullit vlerëson se Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi përcakton qartë se “Kur personat të cilët e konsiderojnë se parimi i trajtimit të barabartë nuk është zbatuar ndaj tyre, paraqesin prova para organit administrativ apo gjykatës kompetente, nga të cilat mund të supozohet se ka pasur diskriminim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë dhe se **barra e provave bie mbi palën e paditur, e cila duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë**”. Bazuar në pohimet e

ankuesit, si dhe procesverbalin e kësaj mbledhjeje, njëri nga anëtarët e Komisionit kishte kërkuar qasje të barabartë ndaj të gjithë kandidatëve në konkurs. Ai ishte anëtar i Komisionit Vlerësues të kandidatit tjetër Z.H, i cili sipas tij po ashtu kishte sjellë nostrifikimin e diplomës pas mbylljes së afatit të konkursit. Dekani përcaktoi kriter tjetër për ankuesin, duke pohuar se çështja e diplomës Bachelor të ankuesit, do të mbetet çështje e MASHT-it. Pikërisht kjo është çështja për të cilën ankuesi pretendon se ndaj tij ishte bërë diskriminim nga Këshilli në fjalë dhe konsideron se trajtimi i tillë nga Komisioni Vlerësues përbën trajtim të pa barabartë në kushte të njëjta. Komisioni Vlerësues, në rastin e ankuesit ka kërkuar rishpallje të konkursit, derisa në konkursin e njëjtë për dy kandidatët tjerë (Z.H dhe H.I.) nuk rekomandohet rishpallja e konkursit. Në këtë frymë Rektorati i Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, i mbetet në barrë që të prezantoj prova bindëse se në konkursin publik të shpallur nga UP, më datës 24 nëntor 2016, për zgjedhjen e personelit akademik nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.

30. Pretendimet e ankuesit se më 31 mars dhe më 13 prill 2017, përmes postës elektronike kishte parashtruar kërkesë tek Sekretarja e Fakultetit Filozofik, për marrjen e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Fakultetit Filozofik të mbajtur më 9 shkurt 2017, por nuk kishte pranuar ndonjë përgjigje, edhe pse kjo e drejtë ankuesit i garantohet edhe me nenin 1 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente publike i cili *“garanton të drejtën e secilit person fizik dhe juridik, pa diskriminim mbi çfarëdo baze, për të pasur qasje, pas kërkesës, në dokumentet e mbajtura, hartuara apo pranuar nga institucionet publike”*.

Konstatimet

31. Nisur nga pohimet e ankuesit dhe dokumentacionin e dorëzuar në IAP, Avokati i Popullit i vlerëson si shqetësuese pohimet e njërit nga anëtarët e Komisionit Vlerësues, A.H., i cili, sipas procesverbalit të mbledhjes së Këshillit të Fakultetit Filozofik, të datës 30 mars 2017, kishte pohuar se ai ishte anëtar i Komisionit Vlerësues edhe tek kandidati tjetër Z.H. dhe që, ky kandidat, kishte sjellë nostrifikimin e diplomës pas mbylljes së konkursit. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se një situatë e tillë përbën trajtim të pabarabartë. Prandaj, në përputhje me nenin 20 paragrafi 2 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, Rektorati i UP dhe Fakulteti Filozofik, ***duhet të dëshmojnë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë.***
32. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen që Fakulteti Filozofik do të duhej t’i përgjigjej ankuesit dhe t’i ofronte procesverbalin e mbledhjes së Këshillit të Fakultetit Filozofik, të mbajtur më 9 shkurt 2017, në përputhje me ligjin për Qasje në Dokumente publike.

Avokati i Popullit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në UP,

REKOMANDON

1. Rektoratit e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” dhe Këshillin e Fakultetit Filozofik:

- Të ndërmarrin veprime të menjëhershme bazuar në kompetencat ligjore për shqyrtimin e pretendimeve të ankuesit për diskriminim, si dhe në përputhje me nenin 20 paragrafi 2 të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, të ofrojnë prova të mjaftueshme për të dëshmuar se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë në konkursin publik të datës 24 nëntor 2016, të shpallur nga Universiteti i Prishtinës, për zgjedhjen e personelit akademik.

2. Inspektoratit e Arsimit në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë:

- Të ndërmarrë veprime të menjëhershme, bazuar në kompetencat ligjore për t’u përgjigjur ankuesit në ankesën e tij me nr. prot. 213, të parashtruar më 13 prill 2017, me pretendime se Këshilli i Fakultetit Filozofik ndaj tij ka kryer veprime diskriminuese.

Në pajtim me nenin 132.3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe me nenet 18.4, 18.6 dhe 25.1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerri, si përgjigje ndaj rekomandimeve të lartpërmendura, jo më vonë se deri më **3 dhjetor 2018**.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit